**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**MINISTRIA E FINANCAVE**
**DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE**
**DEPARTAMENTI TEKNIK**
**DREJTORIA E TARIFËS DHE ORIGJINËS**

Nr. 7623 Prot. Tiranë, më 15.09.2026

**Lënda:** Njoftimi i ri në lidhje me zbatimin e Konventës Rajonale për rregullat e origjinës preferenciale pan-Euro-Mesdhetare ose të protokolleve për rregullat e origjinës të cilat sigurojnë zbatimin e kumulimit diagonal ndërmjet palëve kontraktuese me këtë Konventë.

**DEGËVE DOGANORE**

**AGJENSIVE DOGANORE**

**DEPARTAMENTEVE NË DPD**

Në faqen 'Circab' të Bashkimit Europian është publikuar njoftimi TAXUD/10612313/24 REV.16, datë 31.08.2026 me informacione të përditësuara lidhur me zbatimin e Konventës Rajonale për rregullat e origjinës preferenciale pan-Euro-Mesdhetare[1] të cilat sigurojnë zbatimin e kumulimit diagonal ndërmjet palëve kontraktuese me këtë Konventë.

*Sekretariati i PEM informon se:*

***Kumulimi diagonal sipas Konventës së rishikuar (Vendimi 1/2023 i Komitetit të Përbashkët të Konventës PEM, Ligji 59/2024) ka filluar të zbatohet ndërmjet Kosovës, Norvegjisë dhe Islandës që nga 01.09.2026, si dhe ndërmjet Kosovës, Zvicrës dhe Lihtenshtejnit do të zbatohet nga 01.10.2026.***

**Kumulimi diagonal**
Kumulimi diagonal mund të zbatohet vetëm nëse vendet e prodhimit përfundimtar dhe të destinacionit përfundimtar *zbatojnë Marrëveshje të Tregtisë së Lirë ndërmjet tyre dhe përmbajnë rregulla identike të origjinës me të gjitha palët e përfshira në përftimin e statusit origjinues, psh: me të gjitha palët nga të cilat materialet e përdorura origjinojnë.* Materialet origjinuese në një vend i cili nuk ka një Marrëveshje të Tregtisë së Lirë me vendet e prodhimit përfundimtar dhe/ose të destinacionit përfundimtar do të trajtohen si jo-origjinuese. Shembuj specifikë jepen në notat shpjeguese lidhur me protokollin pan-Euro-Mesdhetare të rregullave të origjinës[2]

[1] Gazeta Zyrtare e Bashkimit Europian Nr. L 54, datë 26.02.2013, p.4 dhe Fletore zyrtare e Shqipërisë Nr 1/2012, datë 26.01.2012
[2] Gazeta Zyrtare e Bashkimit Europian Nr. C 83, datë 17.04.2007, p.1

Në Tabelat bashkangjitur nr. 1, 2 jepet informacion specifik lidhur me mundësitë e zbatimit të kumulimit diagonal bazuar në notifikimet që palët kanë dërguar në Komisionin Evropian:

**Shpjegime lidhur me Tabelat 1 dhe 2**

***Tabela 1****. Pamje e përgjithshme e thjeshtuar e mundësive të kumulimit diagonal në zonën pan-Euro-Mesdhetare.*

Simboli "R" tregon ekzistencën e një marrëveshjeje të tregtisë së lirë ndërmjet 2 vendeve partnere, e cila përmban rregulla të origjinës të cilat lejojnë zbatimin e kumulimit bazuar në rregullat e origjinës së vitit 2023[3]. Për të zbatuar kumulimin diagonal me një vend të tretë partner, simboli "R" duhet të jetë prezent në të gjitha kryqëzimet e tabelës ndërmjet tre vendeve partnere.

Megjithatë, ka disa përjashtime nga kumulimi diagonal. Në kryqëzimin ndërmjet BE dhe TR ndodhet simboli R (1). Në këtë rast simboli (1) tregon që për mallrat e mbuluara nga Bashkimi Doganor ndërmjet BE-së dhe Turqisë, nga data e 27 korrik 2006 zbatohet kumulimi diagonal.

***Tabela 2****. Data e zbatimit të rregullave të origjinës që sigurojnë kumulimin diagonal në zonën pan-Euro-Med.*

- Data e zbatimit të kumulimit diagonal në bazë të Nenit 7 të Shtojcës I të Konventës, siç është ndryshuar me Vendimin Nr. 1/2023 të Komitetit të Përbashkët të Konventës të 7 dhjetorit 2023 (Ligji ynë 59/2024). Në këtë rast, data paraprihet nga '(R)'.

Ky informacion zëvëndëson informacionin "Mbi zbatimin e Rregullave të origjinës preferenciale që parashikojnë kumulimin diagonal ndërmjet palëve kontraktuese zbatuese të rregullave tranzitore në zonën pan-Euro-Mesdhetare" Nr. 9700 Prot i DPD datë 20.05.2026.

Ju faleminderit për bashkëpunimin,

**ZV. DREJTOR I PËRGJITHSHËM**

**Pajtim Melani**

[3] Rregullat e 2023: rregullat në Shtojcën I të Konventës në versionin e saj të ndryshuar me Vendimin Nr. 1/2023 dhe 2/2024 të Komitetit të Përbashkët PEM, (Ligji ynë 59/2024 datë 6 qershor 2024, publikuar në FZ nr.113 datë 4 korrik 2024 dhe Ligji 4/2024 datë 30 janar 2025, publikuar në FZ. Nr. 32 datë 18 shkurt 2025).

## Tabela 1

## Pamje e përgjithshme e thjeshtuar e mundësive të kumulimit diagonal në zonën pan-Euro-Mesdhetare më 1 janar 2025

| | | Vendet EFTA | | | | Pjesemarrësit në Procesin e Stabilizim Asociimit | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | BE | CH (+LI) | IS | NO | TR | AL | BA | XK | ME | MK | XS | MD |
| BE | | R | R | R | R(1) | R | R | R | R | R | R | R |
| CH (+LI) | R | | R | R | R | R | R | R | R | R | R | R |
| IS | R | R | | R | R | R | R | R | R | R | R | R |
| NO | R | R | R | | R | R | R | R | R | R | R | R |
| TR | R(1) | R | R | R | | R | R | R | R | R | R | R |
| AL | R | R | R | R | R | | R | R | R | R | R | R |
| BA | R | R | R | R | R | R | | R | R | R | R | R |
| XK | R | R | R | R | R | R | R | | R | R | R | R |
| ME | R | R | R | R | R | R | R | R | | R | R | R |
| MK | R | R | R | R | R | R | R | R | R | | R | R |
| RS | R | R | R | R | R | R | R | R | R | R | | R |
| MD | R | R | R | R | R | R | R | R | R | R | R | |

(1) Për mallrat e mbuluara nga Bashkimi Doganor BE-Turqi, data e aplikimit është 27 korriku 2006.

## Tabela 2
## Data e zbatimit të rregullave të origjinës që sigurojnë kumulimin diagonal në zonën pan-Euo-Med

| | | Vendet EFTA | | | | Pjesemarrësit në Procesin e Stabilizim Asociimit | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | BE | CH (+LI) | IS | NO | TR | AL | BA | XK | ME | MK | XS | MD |
| BE | | (R)1.1.2025 | (R)1.1.2025 | (R)1.1.2025 | (1) ESCS( R)1.1.2026 AGRI( R)1.1.2026 | (R)1.1.2025 | (R)1.1.2025 | (R)1.1.2025 | (R)1.1.2025 | (R)1.1.2025 | (R)1.1.2025 | (R)1.1.2025 |
| CH (+LI) | (R)1.1.2025 | | (R)1.12025 | (R)1.12025 | (R)1.12025 | (R)1.1.2025 | (R)1.1.2025 | ( R)1.10.2026 | R)1.1.2025 | (R)1.1.2025 | (R)1.1.2025 | (R) 1.4.2025 |
| IS | (R)1.1.2025 | (R)1.12025 | | (R)1.12025 | (R)1.1.2025 | (R)1.1.2025 | (R)1.1.2025 | ( R)1.9.2026 | (R)1.1.2025 | (R)1.1.2025 | (R)1.1.2025 | (R) 1.1.2025 |
| NO | (R)1.1.2025 | (R)1.1.2025 | (R)1.1.2025 | | (R)1.12025 | (R)1.1.2025 | (R)1.1.2025 | ( R)1.9.2026 | R)1.1.2025 | (R)1.1.2025 | (R)1.1.2025 | (R)1.1.2025 |
| TR | (1) ESCS( R)1.1.2026 AGRI( R)1.1.2026 | (R)1.1.2025 | (R)1.1.2025 | (R)1.1.2025 | | (R)1.1.2025 | ( R)1.1.2026 | ( R)1.1.2026 | ( R)1.1.2026 | ( R)1.1.2026 | ( R)13.2.2026 | (R)20.2.2026 |
| AL | (R)1.1.2025 | (R)1.1.2025 | (R)1.1.2025 | (R)1.1.2025 | (R)1.1.2025 | | (R)1.1.2025 | (R)1.1.2025 | (R)1.1.2025 | (R)1.1.2025 | (R)1.1.2025 | (R)1.1.2025 |

| | | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| BA | (R)1.1.2025 | R)1.1.2025 | (R)1.1.2025 | (R)1.1.2025 | ( R)1.1.2026 | (R)1.1.2025 | | (R)1.1.2025 | (R)1.1.2025 | (R)1.1.2025 | (R)1.1.2025 | (R)1.1.2025 |
| XK | (R)1.1.2025 | ( R)1.10.2026 | ( R)1.9.2026 | ( R)1.9.2026 | ( R)1.1.2026 | (R)1.1.2025 | (R)1.1.2025 | | (R)1.1.2025 | (R)1.1.2025 | (R)1.1.2025 | (R)1.1.2025 |
| ME | (R)1.1.2025 | (R)1.1.2025 | (R)1.1.2025 | (R)1.1.2025 | ( R)1.1.2026 | (R)1.1.2025 | (R)1.1.2025 | (R)1.1.2025 | | (R)1.1.2025 | (R)1.1.2025 | (R)1.1.2025 |
| MK | (R)1.1.2025 | (R)1.1.2025 | (R)1.1.2025 | (R)1.1.2025 | ( R)1.1.2026 | (R)1.1.2025 | (R)1.1.2025 | (R)1.1.2025 | (R)1.1.2025 | | (R)1.1.2025 | (R)1.1.2025 |
| XS | (R)1.1.2025 | (R)1.1.2025 | (R)1.1.2025 | (R)1.1.2025 | ( R)13.2.2026 | (R)1.1.2025 | (R)1.1.2025 | (R)1.1.2025 | (R)1.1.2025 | (R)1.1.2025 | | (R)1.1.2025 |
| MD | (R)1.1.2025 | (R)1.4.2025 | (R)1.1.2025 | (R)1.1.2025 | (R)20.2.2026 | (R)1.1.2025 | (R)1.1.2025 | (R)1.1.2025 | (R)1.1.2025 | (R)1.1.2025 | (R)1.1.2025 | |

(1) Për mallrat e mbuluara nga Bashkimi Doganor BE-Turqi, data e aplikimit është 27 korrik 2006. (Kumulimi diagonal me mallrat e mbuluara nga BD është i mundur)

**ANEKSI I**

Njoftimet në lidhje me lëshimin elektonik të certifikatave të qarkullimit EUR.1 sipas paragrafit 1(d) të rekomandimit n. 1/2023 (Ligji 59/2024) dhe Vendimit n. 1/2024 (Ligji 32/2025) të Komitetit të Përbashkët të Konventës.

**Sistemi Novegjez**: Altinn - portali qeverita për dialogun dixhital midis bizneseve, individëve privatë dhe agjencive publike
Data e fillimit: 02.04.2020
Link pë verifikimin e origjinalitetit të certifikatave të qakullimit: https://eu1.toll.no

**Zvicër**
Sistemi: Certifikatë
Data e fillimit: 16 Mars 2026
Lidhje për të verifikuar vërtetësinë e certifikatave të lëvizjes: lidhje unike për çdo lëvizje certifikata fillon me https://certificat.bazg.admin.ch/certificat/views

**Sistemi Turk**: MEDOS - " Sistemi i Automatizimit pë Certifikatat e Oigjinës dhe Certifikatat e Lëvizjes"
Data e fillimit: 24 Pill 2018
Lidhja unike për çdo certifikatë lëvizjeje fillon me
https://mdc.gtb.gov.tr/ , https://uygulama.gtb.gov.tr/ , "https://istanbul.ebilik.net/" and/o "https://ankaa.ebilik.net/dolasim/app".
(aksesohet duke skanuar kodin QR në certifikatë ose duke shtypur shtegun e printuar në certifikatë)